

Rektorja e Universitetit të Elbasanit, Prof. Dr. [Elvira Fetahu](#), mirëpriti Ambasadorin e Spanjës në Tiranë , Sh.T.Z. Álvaro Renedo Zalba

Rektorja e Universitetit të Elbasanit, Prof. Dr. [Elvira Fetahu](#), në kuadër të Javës Ndërkombëtare Erasmus+ në UE , mirëpriti Ambasadorin e Spanjës në Tiranë , Sh.T.Z. Álvaro Renedo Zalba, Koordinatorin e Zyrës Kombëtare Erasmus+, Znj. Ada Ramaj, Zëvendësrektorin për Ndërkombëtarizimin e Universitetit të Jaén, Prof. Dr. José Ignacio Jiménez González, si edhe Zëvendësrektoren për Mobilitetet Ndërkombëtare, Asoc. Prof. Myriam Cano Rubio.

Gjatë këtij takimi, u ndanë përvoja dhe ide konkrete për forcimin e partneriteteve ndërmjet institucioneve akademike, duke theksuar rëndësinë e projekteve të përbashkëta që kontribuojnë në rritjen e cilësisë së arsimit të lartë dhe krijimin e mundësive më të mira për studentët.

